

U

No. 1789/



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

Nr. 6252 datë 10.12.2001

Nr. 3583 datë 27.11.2001

U D H E Z I M

PER PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PER FITIMIN,
RIFITIMIN DHE HEQJEN DORE NGA SHTETESIA SHQIPTARE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 e Kushtetutes,per zbatim te ligjit nr. 8389, date 05.08.1998 "Per shtetesine shqiptare",me qellim qe te unifikohet praktika per shtetesine shqiptare ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise,

UDHEZOJME :

1. Aplikimi nga shtetas te huaj ose shqiptare per fitimi, rifitim ose heqje dore nga shtetesia shqiptare behet ne komisariat te policise vendore ku aplikuesi ka te regjistruar gjendjen civile.

Per shtetasit e huaj,apo shqiptare,qe banojne jashte shtetit aplikimi behet ne perfaqesine diplomatike ose konsullore te Republikes se Shqiperise ne vendin e rezidences se tij,ose ate ne vendin me te pershtatshem per te,kur ne vendin e rezidences se tij nuk ka perfaqesi te tille Republika e Shqiperise.

2. Ne komisariat e policise vendore,punonjesi i caktuar per te huajt dhe pasaporten pret aplikantet per fitim,rifitim ose heqje dore nga shtetesia

